



MISSION IN KOSOVO

**Tryeza e rrumbullakët regjionale mbi formalizimin e vendbanimeve joformale për romët dhe grupet e tjera të rrezikuara
30-31 tetor 2003, Prishtinë/Priština, Kosovë**

Dokumenti përfundimtar i konferencës

Qëllimi

Ky dokument është një rezultat parësor i “Tryeza e rrumbullakët regjionale mbi formalizimin e vendbanimeve joformale për romët dhe grupet e tjera të rrezikuara i mbajtur më 30-31 tetor 2003, Prishtinë/Priština, Kosovë. I hartuar nga pjesëmarrësit, ky dokument është i dizajnuar të koordinojë dhe udhëzojë mbrojtjen dhe formulimin e politikave për vendbanimet joformale në ish Jugosllavi.

Pjesëmarrësit të cilët ishin pjesëmarrës të komuniteteve të rrezikuara dhe përfaqësues të donatorëve duhet të shfrytëzojnë këtë dokument në përpjekjet e tyre për të rregulluar dhe formalizuar vendbanimet joformale në kuadër të komuniteteve të tyre. Ajo mund të shfrytëzohet eventualisht si bazë për hartimin e një kornize regjionale të politikave përkitazi me vendbanimet joformale.

Deklarimi i problemeve

Banorët e vendbanimeve joformale – veçanërisht ata të cilët u përkasin grupeve të rrezikuara, përfshirë këtu romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit – janë të marginalizuar nga komuniteti shumicë. Ata shpeshherë bëhen objekt i shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe gjithashtu nuk u jipet mundësi për të marrur pjesë në qeverisje. Në veçanti, banorët e vendbanimeve joformale nuk gëzojnë të drejta për qasje dhe shfrytëzim të tokës dhe pronës, duke i ofruar mbrojtje nga shkeljet e të drejtave të njeriut siç janë dëbimet me dhunë dhe që ekzekutohen pa vendim gjyqësor. Kjo gjendje duhet të korrigjohet dhe duhet të futet si prioritet në agjendën e qeverisë qendrore dhe atyre lokale.

Përkufizimet

Vendbanimet joformale

Vendbanimet joformale janë janë vendbanime njerëzore të cilat nuk i mundësojnë banorëve të tyre të ushtrojnë të drejtën e tyre themelore për standard adekuat të jetesës, veçanërisht të drejtën për banim adekuat. Si të tilla, vendbanimet joformale mund të posedojnë karakteristikat e paraqitura si në vijim:

- Siguria joformale dhe e pasigurtë e mbajtjes së pronës
- Qasje joadekuate dhe privim nga qasja në shërbimet elementare
- Pjesëmarrja joadekuate dhe privimi nga pjesëmarrja në qeverisje
- Cenueshmëria nga diskriminimi.

Siguria e mbajtjes së pronës¹

Mbajtja e pronës paraqet një marrëveshje ndërmjet një individi dhe/apo grupi dhe një qiradhënësi privat apo publik mbi shfrytëzimin e tokës apo pronës banesore dhe kjo

¹ Dokumenti konceptual i fushatës globale të Habitatit të KB-ve.

marrëveshje qeveriset dhe rregullohet me kornizë ligjore dhe administrative. Siguria e mbajtjes së pronës arrihet kur e drejta për qaje dhe shfrytëzim të tokës është e parashikuar me rregulla të veçantë dhe nëse kjo e drejtë është e arsyetueshme. Një person apo familje thuhet se gëzon të drejtën për siguri të mbajtjes së pronës nëse janë të mbrojtur nga largimi i tyre jovullnetar nga toka dhe vendbanimi përpos nën rrethana të posaçme i cili largim mund të jetësohet vetëm nëpërmjet të procedurës ligjore të njohur dhe pajtuar.

E drejta për qytet

E drejta për qytet nënkupton se çdo person në qytet apo në kuadër të komunitetit ka të drejtë të jetë pjesëtar i barabartë i komunitetit. Si një pjesëtar i barabartë çdo banor i qytetit duhet të gëzojë të njëjtin nivel të realizimit të të drejtës së tij/saj për standard adekuat të jetesës dhe qasje në shërbimet elementare si çdo qytetar tjetër.

Gjetjet e përgjithshme

- **Obligimet:** Qeveritë qendrore dhe lokale kanë për detyrë në bazë të të drejtës ndërkombëtare, veçanërisht pjesës që ka të bëjë me të drejtën për banim adekuat që të sigurojnë që gjendja e banorëve që jetojnë nëpër vendbanime joformale të përmirësohet. Në veçanti, qeveritë duhet të sigurojnë elementet e paraqitura si në vijim: qasjen adekuate në banim, sigurinë ligjore të mbajtjes së pronës, mbrojtjen nga dëbimet me dhunë, disponibiliteti i shërbimeve, materialet, objektet dhe infrastruktura, mundësia e pageës për shfrytëzim të pronës, banueshmëria, qasshmëria për grupet me të meta, lokacioni dhe kushtet adekuate kulturore.
- **Natyra e problemit:** Problemet me të cilat janë përballur banorët e vendbanimeve joformale nuk janë unike për romët, ashkalinjtë, egjiptasit apo grupet tjera të cenuara, mirëpo ato janë më akute për këto grupe për shkak të diskriminimit që u bëhet për shkak se janë pjesëtarë të grupit përkatës.
- **Qëndrimi shoqëror kundrejt ligjeve:** Qëndrimet shoqërore/normat e jo ligjet joadekuate apo jo të mira shkaktojnë këto probleme. Në mënyrë që të fillojmë të përcaktojmë zgjidhjet e qëndrueshme, duhet të shqyrtojmë mënyrën se si zbatohen ligjet adekuate në këtë fushë.
- **Çështja e vendbanimeve njerëzore:** Gjendja e banorëve të vendbanimeve joformale mund të adresohet më së miri nëse konsiderohet si çështje e vendbanimit njerëzor në vend se të shiqohet nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, siç janë e drejta për pronë, e drejta për t'u kthyer në shtëpi, dhe e drejta për të qenë i mbrojtur nga diskriminimi.
- **Përfshirja:** Ndryshimi i perceptimit të autoriteteve qeveritare dhe komunitetit të gjerë për banorët e vendbanimeve joformale në atë mënyrë që këta individë të pranohen si qytetarë të barabartë dhe pjesëtarë të barabartë të komunitetit është me rëndësi kritike në ndryshimin e gjendjes së vendbanimeve joformale.
- **Vetë-avokim:** Banorët e vendbanimeve joformale mund të jenë avokuesit dhe mbrojtësit më të mirë të të drejtave dhe interesave të tyre dhe së këndejmi duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në çfarëdo procesi vendim-marrës mbi statusin e banimit të tyre joformal.
- **Proceset vendim-marrëse:** Proceset gjithëpërfshirëse dhe transparente të vendim-marrjes duhet të gjejnë zgjidhje të kënaqshme reciproke të cilat baraspeshojnë respektimin e të drejtave të njeriut të banorëve të vendbanimeve joformale me interesin publik. Ky proces gjithashtu është i rëndësishëm në baraspeshimin e planifikimit urban dhe atij hapësinor.
- **Qasja shumësektorëshe:** Përqafimi i një qasje shumë sektorëshe në krijimin e sigurisë së mbajtjes së pronës për banorët e vendbanimeve joformale është me rëndësi thelbësore në përmirësimin e gjendjes së banorëve të këtyre vendbanimeve. Një qasje e tillë duhet të mundësojë një qasje adekuate në shërbimet elementare, një drejtësi pa diskriminim, dhe masa mbrojtëse nga dëbimet jashtëgjyqësore të realizuara me dhunë. Një qasje e tillë duhet të ngërthejë në veti gjithashtu edhe elementin e planifikimit të duhur urban dhe atij hapësinor.

Përfundimet

1. Qasja

- **Rekomandohet të përqafohet një qasje e cila është e përqëndruar në sigurimin e të drejtave të barabarta të të gjithëve për qytet. Një qasje e tillë përfshin edhe zhvillimin e një qasje pjesëmarrëse në procesin e vendim-marrjes që ka të bëjë me statusin e vendbanimeve.**

1.1 Parimet e përgjithshme

- **Qeverisja e mirë:** Organet qendrore dhe lokale duhet t'i përmbahen sa më shumë parimeve të qeverisjes së mirë, siç janë mosdiskriminimi, barazia, transparencja dhe llogaridhënia në ofrimin e shërbimeve publike dhe zhvillimi i aktiviteteve tjera. Gjatë ofrimit të ndihmës, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare inkurajohen të vlerësojnë respektimin e këtyre parimeve.
- **Njohja:** Për të adresuar rregullarizimin e vendbanimeve joformale në mënyrë efektive, organet qendrore dhe ato lokale duhet të pranojnë faktin se është në interes të organeve lokale komunale dhe në dobi të komunitetit në përgjithësi adresimi i çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me vendbanimet joformale. Në këtë drejtim organet qendrore dhe ato lokale duhet të pranojnë se vendbanimet joformale karakterizohen nga një sërë elementesh të përziera përfshirë këtu shfrytëzimin formal dhe joformal të pronës, cenueshmërinë e grupeve të caktuara të popullatës, kushtet e vështira shëndetësore, shkalla e lartë e krimit dhe mungesa e shërbimeve dhe infrastrukturës përkatëse.
- **Baraspeshimi:** Organet qendrore dhe lokale duhet të jenë transparente në baraspeshimin e të drejtave të banorëve të vendbanimeve joformale nëpërmjet të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve të prekura në kuadër të këtij procesi vendim-marrës. Nëse pranojmë se interesat e të dyja palëve janë të vlefshme në këtë drejtim mund të na shpiejë drejtë një zgjidhje më të kënaqshme dhe të qëndrueshme.
- **Norma e rregullarizimit:** Rregullarizimi në vend të rivendosjes duhet të jetë një normë që duhet shfrytëzuar gjatë formalizimit të vendbanimeve joformale.
- **Qasja poshtë-lartë:** Qasja poshtë lartë në procesin e pjesëmarrjes mund të inkurajojë politikë bërësit që gjatë hartimit të politikave të tyre të jenë më gjithëpërfshirës. Një qasje e tillë mund të realizohet duke sforuuar shoqërinë civile dhe duke fuqizuar banorët e vendbanimeve joformale që ata të përfaqësojnë vetën në mënyrë adekuate. Organizatat ndërkombëtare, OJQ-të dhe organet qendrore dhe lokale duhet të mbështesin dhe inkurajojnë nismat e tilla.

1.2 Pjesëmarrja dhe ngritja e vetëdijes

- **Dialogu:** Duhet ndërmarrë hapa përkatës në përmirësimin e procesit të dialogut dhe ndërtimin e mirëbesimit ndërmjet banorëve të marginalizuar të vendbanimeve joformale dhe hartuesve të politikave. Hapat e tillë duhet të ndërmirren si rezultat i praktikave të mirë të vendeve tjera dhe mësimave të mësuara nga e kaluara.
- **Angazhimi i komuniteteve:** Pjesëmarrja efektive e banorëve të vendbanimeve joformale është me rëndësi kritike për gjetjen e zgjidhjeve kreative dhe të qëndrueshme për problemet që kanë të bëjnë me të drejtën e tyre për strehim adekuat. Organet qendrore dhe lokale inkurajohen të angazhohen në përpjekjet drejt zhvillimit të një qasje

gjithëpërfshirëse dhe njohjes së rolit të shoqërisë civile në identifikimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.

- **Pronësia lokale:** Për të siguruar zgjidhje të qëndrueshme, pronësia e komuniteteve të prekura ndaj procesit duhet të inkurajohet sa më shumë së bashku me mobilizimin e kapacitetit të mundshëm të të gjitha palëve të interesuara, veçanërisht të banorëve të vendbanimeve joformale.
- **Roli i grupeve të cenuara:** Organet qendrore dhe ato lokale së bashku me të gjitha palët e interesuara në proces duhet të identifikojnë rolin e qartë të grupeve të marginalizuara dhe atyre që gjenden në pozitë më pak të favorshme. Në dizajnimin e strategjive dhe politikave për adresimin e çështjes së vendbanimeve joformale, organet qendrore dhe lokale inkurajohen që të angazhohen në aktivitete të ndryshme në partneritet të ngushtë me komunitetet, popullatën e rrezikuar dhe atë që gjendet në pozitë jo të favorshme dhe të promovojnë pjesëmarrjen e tyre me qëllim të fuqizimit të rolit të tyre.
- **Shfrytëzimi i kornizës:** Komunitetet inkurajohen të përfitojnë nga korniza institucionale e cila është themeluar me qëllim të sigurimit të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së komuniteteve, veçanërisht të grupeve të cenuara të popullatës. Kur ato nuk ekzistojnë, atëherë organet qendrore dhe lokale inkurajohen fuqimisht të japin ndihmën e tyre në themelimin e mekanizmave për pjesëmarrje dhe përfaqësim.
- **Organizatave të shoqërisë civile:** Roli i organizatave të shoqërisë civile në përpjekjet për rregullarizimin e vendbanimeve joformale duke ofruar ndihmë teknike, mbështetje afatgjate në çështjet që kanë të bëjnë me dokumentimin dhe dëshmitë dhe përkrahje në zbatimin dhe monitorimin e procesit duhet të pranohet dhe shfrytëzohet nga të gjitha palët e interesuara.
- **Ngritja e vetëdijes:** Duhet të bëhen përpjekje për ngritjen e vetëdijes në mesin e grupeve të rrezikuara për të drejtën e tyre për banim adekuat dhe t'ju tregohet atyre se si mund të realizojnë këto të drejta përfshirë këtu edhe qasjen në informim. Nëpërmjet të pranimit të problemit dhe ngritjes së vetëdijes si organet qeveritare ashtu edhe komunitetet e prekura mund të angazhohen në dialog konstruktiv në atë se si politikat mund të përmirësojnë gjendjen e banorëve të vendbanimeve joformale.
- **Ndihma ligjore:** Organet qendrore dhe lokale duhet të japin ndihmën e tyre në ofrimin e ndihmës ligjore për banorët e vendbanimeve joformale dhe grupve të tjera cenuara nëpërmjet të përkrahjes së OJQ-ve apo organizatave të cilat ofrojnë një ndihmë të tillë.

2. Krijimi i sigurisë së mbajtjes së pronës

2.1 Rekomandimi i ndryshimeve të gjera në hartimin e politikave

- **Lehtësimi:** Politikat dhe ligjet duhet të ndërtohen në atë mënyrë ashtu që të mundësojnë rregullarizimin e vendbanimeve joformale në mënyrë që rregullarizimi i vendbanimeve joformale të bëhet rregull e jo përjashtim. Mungesa e dokumentacionit personal mund të minimizohet si pengesë në formalizimin/rregullarizimin e vendbanimeve joformale.
- **Shqyrtimi dhe harmonizimi i ligjeve:** Organet qendrore dhe lokale inkurajohen të shqyrtojnë kornizën ekzistuese ligjore dhe mekanizmat/veprat tjerë ligjor si dhe të shfrytëzojnë interpretimin inovativ të ligjeve ekzistuese në mënyrë që komunitetet të përfitojnë nga përmirësimi i gjendjes së tyre.
- **Privatizimi:** Në mënyrë të veçantë, gjatë transformimit nga ekonomia socialiste në atë të tregut, organet qendrore dhe lokale duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme që të minimizojnë ndikimin negativ të saj në të drejtën për banim adekuat. Përpjekjet e tilla përfshijnë edhe dhënien e mundësisë komunave që të ofrojnë alternativa të qëndrueshme

gjatë përpjekjeve për rregullarizimin e vendbanimeve joformale siç janë kontratat e qirasë dhe zgjatja e tyre.

2.2 Rekomandimi i hapave përkatës

- **Analiza e situatës:** Para hartimit të politikave, organet qendrore dhe lokale inkurajohen të zhvillojnë një analizë **gjithëpërfshirëse** të situatës të vendbanimeve joformale në këtë fushë, e cila ndërthet në veti edhe diskutimet e hapura me banorët e vendbanimeve joformale.
- **Plani i veprimit:** Pasi të jetë kryer analiza e gjendjes, organet qendrore dhe lokale në bashkëpunim me palët tjera të interesuara inkurajohen të hartojnë një plan të veprimit për çështjen e vendbanimeve joformale.
- **Sigurimi i adresave, individualizimi:**² Organet përkatëse duhet të japin ndihmën në sigurimin e adresave zyrtare dhe individuale për banorët e vendbanimeve joformale ashtu që ata të jenë në gjendje të zgjidhin çështjet rreth dokumentacionit dhe të kenë mundësi që me lehtë të gëzojnë qasje në shërbimet elementare sikurse edhe krijojnë një autonomi të tyre në kuadër të vendbanimit. Ofrimi i ndihmës teknike i cili inkurajon individualizimin siç është vendosja e matësve të rrymës dhe ujit duhet të bëhet sa më shpejtë.
- **Arranzhimet alternative dhe inovative përkitazi me shfrytëzimin e pronës:** Në formalizimin/rregullarizimin e vendbanimeve joformale, organet qendrore dhe lokale inkurajohen të gjurmojnë për forma alternative të sigurisë së mbajtjes së pronës përpos dhënies së titullit të pronarit, siç janë dhënia e tokës/pronës me qira nga ana e autoriteteve lokale dhe arranzhimet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin në grup të pronës.
- **Qasja në dokumente:** Organet qendrore dhe lokale inkurajohen të japin ndihmën e tyre në sigurimin e dokumenteve dëshmi dhe provave tjera të pronësisë veçanërisht për shkak të mungesës së dokumentacionit personal në mesin e romëve, ashkalinjëve, egjiptasve dhe banorëve tjerë të vendbanimeve joformale. Një lehtësim i tillë përfshin edhe thjeshtësimin e procedurave, ofrimin e amnestisë për ata pa dokumente për rregullarizimin e statusit të tyre, zhvillimin e fushatave për ngritjen e vetëdijes.
- **Kriteret e zotësisë juridike:** Gjatë formalizimit/rregullarizimit të vendbanimeve joformale, organet qendrore dhe lokale inkurajohen të përcaktojnë kriteret e zotësisë juridike për të cilat janë transparente, jodiskriminuese dhe korrekte. Autoritetet duhet gjithashtu të marrin parasysh kohëzgjatjen brenda së cilës komuniteti ka okupuar vendbanimin joformal me pëlqim shprehimor nga ana e organeve lokale.
- **E drejta për kthim:** Gjatë adresimit të çështjes së rregullarizimit të vendbanimeve joformale, organet qendrore dhe lokale, në bashkëpunim me komunitetet e prekura, inkurajohen të hartojnë programe dhe projekte për mbrojtjen e të drejtave të personave të zhvendosur dhe refugjatëve për t'u kthyer në shtëpitë e tyre.

2.3 Aktivitetet e rekomanduara të planifikimit urban

- **Përshtatja e planeve urbane ndaj realitetit:** Planet urbanistike duhet të pasqyrojnë nivelin e shfrytëzimit të tokës në një zonë të caktuar, përfshirë këtu edhe vendbanimet joformale. Futja e vendbanimeve joformale në kuadër të planeve urbanistike përmirëson sigurinë e mbajtjes/shfrytëzimit të pronës dhe duhet të shiqohet më shumë si një rregull

² Individualizimi paraqet thjeshtë një ofrim të qasjes individuale në shërbimet elementare duke siguruar adresat shtëpiake dhe matësit individual të rrymës dhe ujit.

sesa një përjashtim. Si të tilla vendbanimet joformale ekzistuese duhet të përfshihen në kuadër të procesit të evidentimit të tyre para hartimit të planit urbanistik.

- **Kuptimi i natyrës së vendbanimit:** Hartuesit e politikave duhet të marrin parasysh edhe vlerësimet që kanë të bëjnë me lokacionin, llojin dhe natyrën e vendbanimeve joformale (toka publike/private etj) sikurse ato që parashihen me analizat e gjendjes gjatë shqyrtimit të planeve urbanistike.
- **Pranimi i stimulimeve për përfshirje:** Në mënyrë që planifikimi urban të ndihmojë në rregullarizimin e vendbanimeve joformale, nevojitet të bëhen përpjekje për të ndryshuar perceptimin e hartuesve të politikave për vendbanimet joformale dhe inkurajohet përfshirja e komuniteteve në programet zhvillimore ekonomike.
- **Trajnimi:** Nevojitet të bëhet trajnimi profesional i autoriteteve qendrore dhe lokale për planifikim urban për zgjerimin e të menduarit të tyre në këtë fushë dhe së këndejmi preferohet të inkurajohet inovacioni gjatë marrjes parasysh të opcioneve të ndryshme të planifikimit urban siç është rregullarizimi në vend të zhvendosjes dhe mbrojtja e të drejtave për banim joformal. Trajnimet e tilla do të ngërthenin në veti shfrytëzimin e praktikave të mira, skemave pilot, etj...
- **Procesi gjithëpërfshirës dhe transparent i planifikimit:** Në mënyrë që procesi i planifikimit të baraspeshojë në mënyrë të duhur interesat e komuniteteve të prekura me interesin publik, procesi i planifikimit duhet të jetë konsultativ dhe të përfshijë pjesëmarrjen efikase të të gjithë banorëve të vendbanimeve joformale, komuniteteve të rrezikuara si dhe publikut të përgjithshëm. Autoritetet qendrore dhe lokale inkurajohen të jenë transparente në baraspeshimin e interesave gjatë hartimit të planeve urbanistike.
- **Ngritja e vetëdijes mbi planifikimin urban:** Në mënyrë që një proces i tillë gjithëpërfshirës të jetë i suksesshëm duhet të bëhen përpjekje për të ngritur vetëdijen dhe kuptimin e kërkesave dhe procedurave që duhet plotësuar në lidhje me planifikimin urban.

3. Mundësimi i parandalimit dhe qëndrueshmërisë

3.1 Siguria

- **Siguria e kërkuar:** Duhet të bëhen përpjekje për të siguruar një siguri afatshkurtë dhe afatgjatë të banorëve dhe posedimeve të tyre në vendbanimet joformale.
- **Siguria është me rëndësi kritike:** Siguria dhe mbrojtja efikase e individëve dhe strukturave – në veçanti e shtëpive – është me rëndësi jetike për qëndrueshmërinë e formalizimit/rregullarizimit të vendbanimeve joformale. Gjatë rehabilitimit pas-konfliktit të vendbanimeve joformale, mbrojtja e banorëve, të kthyerve dhe të tjerëve në vendbanimet apo shtëpitë të cilat ishin në rindërtim e sipër duhet të jetë me rëndësi thelbësore. Zhvillimi i aktiviteteve afatgjatë policore dhe mbrojtja e vendbanimeve të ekspozuara ndaj rrezikut të banuara me pjesëtarë të pakicave është me rëndësi jetike për qëndrueshmërinë e procesit të rregullarizimit të vendbanimeve joformale.
- **Zhvillimi i aktiviteteve policore dhe hartimi i politikave të sigurisë:** Zgjidhjet kreative të cilat mund të arrihen vetëm pas shumë konsultimeve të hollësishme me komunitetet minoritare të prekura kanë për qëllim të adresojnë çështjet që kanë të bëjnë me kryerjen e aktiviteteve policore. Për këtë arsye duhet të vendoset një baraspeshë ndërmjet shqetësimeve që kanë të bëjnë me rendin publik dhe rrezikun e profilizimit racor.
- **Bashkëveprimi:** Policia nuk duhet të jetë vetëm një ndërfaqje ndërmjet banorëve të komuniteteve minoritare që banojnë në vendbanimet joformale dhe popullatës shumicë. Veçanërisht kur kemi të bëjmë me kthimin e pakicave, kyçja e të gjithë palëve të

interesuara – si nga popullata pakicë gjithashtu edhe nga ajo shumicë – në procesin e kthimit është me rëndësi kritike për krijimin e një mjedisi të sigurtë.

- **Aspektet tjera të sigurisë:** Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme, siç është vendosja e dritave në rrugë, kërkohet për të arritur sigurinë e duhur në vendbanimet joformale dhe duhet të përfshihet në procesin e formalizimit të vendbanimeve joformale.

3.2 Drejtësia

- **Gjyqësia e pavarur:** Qasja e banorëve të vendbanimeve joformale në gjyqësinë funksionale dhe të pavarur duhet të përmirësohet në këtë drejtim. Qasja efikase dhe e barabartë në drejtësi e cila siguron proces të rregullt gjyqësor dhe mbrojtjen efikase të të drejtave të njeriut mund të kontribuojë në formalizimin e vendbanimeve joformale.
- **Ndjekja penale e veprave me motive etnike:** Gjyqësia duhet të sigurojë mbrojtjen efikase të viktimave të krimeve me motive etnike dhe informata mbi ndjekjen penale të suksesshme të kryesve të veprave të tilla penale të cilat duhet t'ju shpërndahen të gjitha mjeteve të informimit publik si atyre minoritare ashtu edhe atyre të popullatës shumicë.
- **Drejtësia dhe pajtimi në periudhën pas konfliktit:** Kryesit e veprave penale të kryera gjatë konfliktit ndëretnik duhet të ndjekën penalisht. Zbatimi i drejtësisë paraqet një komponentë të ndërlikuar në procesin e pajtimit ndëretnik dhe është me rëndësi jetike në shtimin e besimit të grupeve të rrezikuara në drejtësinë.

3.3 Mosdiskriminimi/lufta kundër diskriminimit

- **Shtresat e ndryshme të diskriminimit:** Autoritetet qendrore dhe lokale duhet të marrin parasysh se diskriminimi kundër banorëve të vendbanimeve joformale mund të ndërlihdet me statusin e tyre si pjesëtar të një grupi të caktuar siç janë bashkësitë e pakiceve.
- **Vlerësimi i efekteve diskriminuese:** Kur autoritetet qendrore dhe lokale të vendosin mbi veprimet dhe politikat që ndikojnë në të drejtat e banorëve të këtyre vendbanimeve, ato duhet të përcaktojnë nëse veprimet e tilla vëjnë në baraspeshë të duhur interesin publik me interesat e individëve të prekur duke qenë të arsyeshme, justifikueshme dhe proporcionale me qëllimin e veprimeve të policisë me qëllim të eliminimit të veprimeve apo politikave diskriminuese në fuqi.
- **Ligjet kundër diskriminimit:** Autoritetet qendrore dhe lokale duhet të mbështesin , ndërsa komunitetet minoritare duhet të avokojnë, për hartimin e ligjeve gjithëpërfshirëse kundër diskriminimit në pajtim me standardet evropiane.
- **Detyrimet për mosdiskriminim:** Për shkak të mundësisë se disa grupe etnike mund të jenë të tejpreferuara në mesin e banorëve të vendbanimeve joformale, organet qendrore dhe lokale duhet të përmbushin detyrimet e tyre për të mos kryer veprime diskriminuese. Organet qendrore dhe lokale duhet të mbledhin shënime të sakta mbi përbërjen etnike të banorëve të këtyre vendbanimeve joformale në mënyrë që të sigurojë se janë zhvilluar politikat e duhura në këtë drejtim.

3.4 Arsimimi

- **Qasja e barabartë në arsimim:** Për shkak të rrezikut të segregacionit etnik në shkollat të cilat janë nën standardin e duhur të cilat gjenden afër vendbanimeve joformale, proceset e rregullarizimit dhe formalizimit duhet të jenë të lidhura ngushtë me politikat që janë dizajnuar me qëllim të ofrimit të qasjes së barabartë në arsimim për të gjithë.
- **Pjesëmarrja në procesin e desegregimit:** Në dizajnimin e programeve integruese, është me rëndësi thelbësore të konsultohen të gjitha palët e interesuara. Organet arsimore dhe

komunale sikurse edhe prindërit e komuniteteve pakicë dhe shumicë duhet të jenë të përfshirë në këtë drejtim.

- **Edukimi parashkollor:** Organet qendrore dhe lokale duhet të japin ndihmën në sigurimin e arsimimit parashkollor për fëmijët e përkatësisë rome dhe fëmijët e grupeve tjera të cenuara. Një arsimim i tillë i dizajnuar në atë mënyrë ashtuqë të jetë në gjendje të marrë parasysh interesat më të mira të fëmijëve paraqet thelbin e tranzicionit të suksesshëm të tyre në shkollat e integruara.

3.5 Shërbimet shëndetësore dhe sociale

- **Përmirësimi i kushteve shëndetësore:** Gjatë formalizimit/rregullarizimit të vendbanimeve joformale, organet qendrore dhe lokale duhet të përpilojnë listën e prioriteteve për eliminimin e kërcënimeve për shëndetin e banorëve të këtyre vendbanimeve. Kushtet e vështira në shumicën e vendbanimeve joformale paraqesin *de facto* një kërcënim për realizimin e të drejtës për dhëndet fizik dhe mental në bazë të standardeve më të larta.
- **Qasja në shërbimet e kujdesit shëndetësor:** Qasja e garantuar e banorëve të vendbanimeve joformale në kujdesin shëndetësor primar dhe atë emergjent duhet të përfshihet në kuadër të procesit për rregullarizimin/formalizimin e vendbanimeve joformale.

3.6 Punësimi

- **Mbështetja e gjenerimit të të ardhurave:** Gjatë procesit të formalizimit/rregullarizimit, organet qendrore dhe lokale duhet të kërkojnë nga bizneset e vogla dhe projektet bujqësore nëpërmjet të trajnimit dhe huave të vogla. Kjo mbështetje duhet të realizohet drejtpërdrejtë apo nëpërmjet të OJQ-ve përkatëse.
- **Qasja në punësimin publik:** Për shkak të varfërisë ekstreme e cila mbizotëron në kuadër të vendbanimeve joformale, organet qendrore dhe lokale duhet të përfshijnë projektet e ndryshme të punëve publike të cilat janë të dizajnuara për punësimin e vendbanimeve joformale në procesin e formalizimit të vendbanimeve joformale. Projektet e tilla të punëve publike mund të përmirësojnë gjendjen e mjedisit që mbizotëron në kuadër të vendbanimeve joformale.

3.7 Banimi

- **Politikat e banimit:** Organet qendrore dhe lokale inkurajohen të hartojnë politika gjithëpërfshirëse të banimit social, përfshirë këtu edhe programet për strehim. Politikat e banimit të cilat miratohen duhet të bazohen në njohjen e të drejtës për qytet për të gjithë dhe të strehimit të të gjithë personave pa marrë parasysh statusin e tyre. Politikat e tilla duhet të jenë të financuara në mënyrë të duhur, sipas mundësisë nëpërmjet të buxhetit lokal apo qendror edhe pse autoritetet inkurajohen të kërkojnë financim ndërkombëtar, nëse për një gjë të tilla paraqitet nevoja.
- **Diskriminimi pozitiv në politikat e banimit:** Në veçanti, për shkak të cenueshmërisë së shumë banorëve të vendbanimeve joformale, organet qendrore dhe lokale inkurajohen të inkorporojnë masa të ashpra kundër diskriminimit në kuadër të politikave mbi qasjen në banim privat dhe publik, përfshirë këtu edhe banimin social. Masat thelbësore që kanë të bëjnë me banimin publik përfshijnë:
 - Dispozitat e fuqishme ligjore që kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit në qasjen në banim social;
 - Kuotës në ofrimin e banimit social për pjesëtarët e grupeve të rrezikuara;

- Transparencës nëpërmjet monitorimi të pavarur dhe sigurimit të rregullt të shënimeve në bazë të përkatësisë etnike mbi personat të cilave u është ofruar banimi social apo ndonjë ndihmë tjetër.